



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samopravo
Ministry of local government Administration

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Shpall :

KONKURS

Pozita :	Një (1)	Zyrtar për investime publike të komunave
Departamenti / Zyra:		Departamenti për bashkëpunim dhe zhvillim rajonal
Nr. i referencës:		BZHR-2/1-19/MAPL
Grada :		Koeficienti 7
Raporton :		Udhëheqësi i Divizionit
Mbikëqyrje e stafit :		Nuk ka

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Të analizojë problemet, të identifikojë zgjidhjet alternative, të parashikojë pasojat e veprimeve të propozuara dhe të zbatojë rekomandimet për mbështetjen e investimeve publike;
2. Të sigurojë komunikim dhe informacione brenda Ministrisë përkitazi me aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me buxhetin komunal dhe me investimet publike;
3. Të sigurojë se progresi i investimeve publike të komunave është i planifikuar dhe siguron mbikëqyrje për zbatimin e investimeve publike;
4. Të sigurojë që administratat komunale janë duke marrë mjete të mjaftueshme buxhetore për sigurimin e fondeve për investime publike bazuar në kriteret;
5. Të ofrojë mbështetjen për komunat gjatë hartimit të planeve të tyre për investime publike;
6. Të sigurojë përgatitjen dhe analizën sipas nevojës të raporteve gjashtëmujore apo vjetore mbi investimeve publike;
7. Të përgatitë raporte periodike të punës;
8. Të kryejë edhe detyra të tjera me kërkesë të Udhëheqësit të Divizionit dhe udhëheqësit të Departamentit;

Kualifikimet dhe Përvoja:

Të ketë diplomë universiteti në fushën e ekonomisë, financave;
Së paku 2 vite përvojë punë laminë perkatëse.

- Të ketë shkathtësi për të raportuar lidhur me ligjet perkatëse shtetërore, si dhe rregulloret të cilat kanë të bëjnë me fushën e investimeve publike;
- Të jetë i aftë për të punuar brenda afateve të ngushta kohore, që të punojë nën stres dhe të dijë si të gjendet në situata të vështira;
- Të ketë aftësi për identifikimin e pavarur dhe analizën komplekse të investimeve publike dhe të problemeve të ndërlikuara financiare, si dhe për bashkërendimin

e duhur të zbatimit të zgjidhjeve;

- Të ketë shkathtësi të dëshmuara për planifikim dhe të jetë i aftë për realizimin e planeve;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme për të komunikuar qoftë me gojë apo me shkrim si dhe të ketë aftësi të mira ndër-personale;
- Njohje të gjuhëve zyrtare;
- Shkathtësi pune me kompjuter (aplikacionet Microsoft, Internet etj.)

Aktet ligjore dhe aktet nën -ligjore që rregullojnë rekrutimin

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligji Nr. 03/L -149 Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil .

Kohëzgjatja e emërimit

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit për pozitën Zyrtar për Investime publike te komunave është pa afat në përputhje me LSHCK Nr.03/L -149 , në të cilën është e përfshirë perioda e punës provuese njëvjeqare (1) , për pozita të karrierës

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Formularët zyrtarë për aplikim merren në Zyrën e Personelit të MAPL-së, Kati XII -zyra 1203 , ndërtesa e ish-Rilindja gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga Web Faqja e MAPL -së.

Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmive për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj, mund të dorëzohen drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MAPL-së dhe përmes postës

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar(postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Procedura e Konkurrimit

Procedura e konkurrimit është e jashtme dhe të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës se Kosovës
Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit .

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në Web-Faqen e Ministrisë:
mapl.rks-gov.net.

Për informata shtesë mund të kontaktoni Zyrën e Personelit të MAPL-së, në telefonin: **038-200 35-511**